

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Transportonin emigrantë të paligjshëm, makinat përplasën patrullën e policisë dhe largohen me shpejtësi
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/transportonin-emigrante-te-paligjshem-makinat-perplas-in-patrullen-e-poli-i588589
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 16:30:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 16:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	44d93da926848e5e0037d87a0f4fbc430de4ab1de9fbcc613e795dae22263106
TEKSTI	f5d7cfeb28fcaa21513c7a6c9247d499ae0ac24e0ad2ff380a7e9eed6f8fc65
PAMJA	2c5bfddc25a0d5b86f74d78e8f8c37da8f78b1684c1a231912412bfff82630d22

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	964afbb78ef61e6290c35210135f259b4439563a4ff11fe87731a8aa983915be
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f11c1668384a0114026088dd439e5bbabdb3d48a586475de97c9d12c35b4ba6b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/964afbb78ef61e6290c35210135f259b4439563a4ff11fe87731a8aa983915be>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by



English



ie Transportonin emigrante te paligjshem, makinat perplasjin patrullen e policise dhe largohen me shpejtesiLa "thate" Gjermanine dhe pranoi itesen e Kosoves, Erblin Osm: fundit

Transportonin emigrantë të paligjshëm, makinat përplasjin patrullën e policisë dhe largohen me shpejtësi



26 Shtator 2026, 18:30Kronika TEMA



Dy automjete tip Audi Q7 nuk iu bindën urdhrat të policisë për të ndaluar, përplasën patrullat në një postbllok dhe u larguan me shpejtësi. Ngjarja ndodhi mbrëmjen e kaluar në aksin Kapshticë–Lozhan–Gramsh, ku policia dyshon se mjetet po përdoren për transport të emigrantëve të paligjshëm.

Operacioni nisi në afërsi të Kapshticës, në Devoll, ku shërbimet e policisë konstatuan dy automjetet Audi Q7 dhe nisën ndjekjen e tyre. Gjatë lëvizjes, drejtuesit dyshohet se braktisën rreth 15 emigrantë në afërsi të Lozhanit, përpara se të vijonin në drejtim të Gramshit.

Në një postbllok të ngritur në Gramsh, dy automjetet nuk iu bindën urdhrat për ndalim dhe u përplasën me patrullat e policisë, duke rrezikuar edhe punonjësit e shërbimit. Pavarësisht përplasjes, drejtuesit vijuan largimin me shpejtësi.

Më pas, të dy automjetet u gjetën të braktisura në dy fshatra të Gramshit. Ndërkohë, 15 emigrantët u lokalizuan të fshehur në një përrua pranë fshatit Lozhan.

Në kuadër të operacionit, dy automjetet u sekuestruan, ndërsa policia ka identifikuar edhe dy drejtuesit e tyre, të cilët janë shpallur në kërkim. Për një person të tretë është bërë procedimi penal në gjendje të lirë.

Operacioni u zhvillua nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit Korçë, strukturat hetimore të DVP Korçë, në bashkëpunim me Komisaratin e Policisë Gramsh dhe Komisaratin nr. 5 të Tiranës.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Shpërthen në flakë autobusi në hyrje të tunelit të Elbasanit, bllokohet rruga](#)

17:08 Kronika

Katër anëtarë të familjes shqiptare u shuan në Athinë! Florinda dhe bashkëshorti ishin në muaj mjalti, vëllai i saj dhe kunata po prisnin një fëmijë

16:00 Kronika

[U dërgua në spitalin e Durrësit pas rënies në kontakt me rrymën elektrike kur punonte në varkë, humb jetën 28-vjeçari nga Filipinet](#)

15:30 Kronika

[Kush është Indrit Dokle, që u rishpall në kërkim nga SPAK ditën e sotme për akuzat e trafikut të drogës dhe grupit kriminal?](#)

15:00 Kronika / 1 koment



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.